



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 5 paragrafi (2), neni 6 dhe neni 26 paragrafi (1) nën paragrafi (1.1), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 09/2023 PËR PËRJASHTIM GRUPOR TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË SPECIALIZIMIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është të përcaktojë kategoritë e marrëveshjeve të specializimit që Autoriteti i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) i konsideron se plotësojnë normalisht kushtet e parashikuara në nenin 5, pika 2, të ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm Ligji). Të vlerësohet ndikimi i këtyre marrëveshjeve në tregun përkatës, dhe të përcaktohen rastet kur këto marrëveshje nuk i nënshtrohen përjashtimit.

Neni 2 Përkufizimet

- 1.1. 'marrëveshje specializimi' nënkupton një marrëveshje e njëanshme specializimi, një marrëveshje reciproke specializimi ose një marrëveshje për prodhim të përbashkët;

1.1.3. 'marrëveshje për prodhim të përbashkët' nënkupton një marrëveshje sipas së cilës dy ose më shumë palë bien dakord të prodhojnë produkte të caktuara së bashku;

1.2. 'marrëveshje' nënkupton një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve, një vendim nga një shoqatë ndërmarrjesh Ose një praktikë e bashkërenduar;

1.6. 'produkt specializimi' nënkupton një produkt që prodhohet në bazë të një marrëveshje specializimi;

1.9.2.'konkurrent i mundshëm' nënkupton një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes së specializimit, do të kishte gjasa që, mbi baza realiste dhe jo thjesht si një mundësi teorike, të ndërmente, brenda jo më shumë se 3 viteve, investimet e nevojshme shtesë ose kostot e tjera të nevojshme për të hyrë në tregun përkatës;

1.10. 'detyrim i furnizimit ekskluziv' do të thotë një detyrim për të mos furnizuar produktet e specializimit një ndërmarrje konkurruese, përveç një pale Ose palëve në marrëveshjen e specializimit;

1.12. 'e përbashkët', në kontekstin e shpërndarjes (distribuimit), nënkupton aktivitetet ku puna e përfshirë është:

1.12.1. kryhet nga një ekip, organizatë ose ndërmarrje e përbashkët; ose

1. 13.'distribuim' nënkupton shitjen dhe furnizimin e produkteve të specializimit për klientët, duke përfshirë komercializimin e këtyre produkteve.

1.14. 'Ndërmarrje të lidhura' nënkupton:

1.14.1. ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e specializimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi ka një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e mëposhtme:

1.14.1.2.kompetenca për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen;

1.14.1.3.të drejtën për të menaxhuar punët e ndërmarrjes;

1.14.2. ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshjen e specializimit, një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 1;

1.14.3. ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën 2 ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 1;

1.14.5. ndërmarrjet në të cilat një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e renditura në pikën 1 mbahen bashkërisht nga:

1.14.3.1.palët në marrëveshjen e specializimit ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura të përmendura në pikat 1 deri në 4 ose

Neni 3 Përfshirje

3, Përfshirja e përcaktuar në paragrafin 1 do të zbatohet gjithashtu për marrëveshjet e specializimit, të cilat përfshijnë dispozita për dhënien ose licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për një ose më shumë nga palët, me kusht që këto dispozita të lidhen drejtpërdrejt me,

dhe të nevojshme për, zbatimin e marrëveshjes dhe nuk përbëjnë objektin parësor të marrëveshjes.

4. Përjashtimi i përcaktuar në paragrafin 1 do të zbatohet gjithashtu për marrëveshjet e specializimit ku:

- 4.1. Palët bien dakord për një blerje ekskluzive ose detyrim ekskluziv për furnizim; ose
- 4.2. Palët bashkërisht shpërndajnë produktet e specializuara

Neni 4

Pragu i pjesëmarrjes në treg

2.1. pjesa e kombinuar e tregut të palëve nuk kalon 20% në tregun (tregjet) përkatës të cilit i përket produktet e specializimit;

2.2. pjesa e kombinuar e tregut të palëve nuk kalon 20% në tregun (tregjet) përkatës të cilit i përket produktet e rrjedhës së poshtme.

Neni 5

Zbatimi i pragut të pjesëmarrjes në treg

1. Për qëllime të zbatimit të pragut të pjesës së tregut të parashikuar në nenin 4, zbatohen rregullat e mëposhtme:

1.1. pjesët e tregut do të llogariten në bazë të vlerës së shitjes në treg; nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg nuk janë të disponueshme, mund të përdoren vlerësime të bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë vëllimet e shitjeve në treg;

Neni 6

Kufizimet e rënda

1, Përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 nuk do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të veçuara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si Objekt njëri nga sa vijon:

1.1. fiksimit e çmimeve gjatë shitjes së produkteve të specializimit palëve të treta, me përjashtim të fiksimit të çmimeve të ngarkuara për klientët e menjëhershëm në kontekstin e shpërndarjes së përbashkët;

1.2. kufizimin e produkteve ose shitjeve, me përjashtim të:

1.4. përcaktimin e kapacitetit dhe vëllimeve të prodhimit në kontekstin e një marrëveshjeje të përbashkët prodhimi;

1.5. përcaktimin e objektivave të shitjeve në kontekstin e shpërndarjes së përbashkët;

1.6. ndarjen e tregjeve Ose të klientëve.

Neni 7

Tërheqja në raste individuale nga Komisioni

2. Komisioni mund të tërheqë përfitimin e përjashtimit të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ në përputhje me nenin 55 paragrafi 1 pika 1.2, veçanërisht kur tregu përkatës është shumë i përqendruar dhe konkurrenca tashmë është e dobët, për shembull për shkak të një ose më shumë nga sa vijon:

2.1. përqindjeve individuale në treg të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;

2,3. lidhjeve ndërmjet palëve të pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

Periudha kalimtare

Ndalimi i parashikuar në nenin 5 paragrafi 1 të ligjit nuk do të zbatohet gjatë periudhës prej [ditës së hyrjes në fuqi] për marrëveshjet të cilat janë në fuqi [ditës para ditës së hyrjes në fuqi] e që nuk përmbushin kushtet për përjashtim të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, por që plotësojnë kushtet për përjashtim të përcaktuara me Rregulloren Nr. 02/2019 për disa kategori të marrëveshjeve të specializimit.

Neni 9

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës